

Elkana Zykaj ka përfunduar studimet në Administrim Biznesi me fokus në Menaxhim dhe Operacione në Universitetin e Tiranës.

Aktualisht mabn pozicionin si Koordinator e Sektorit të Standardeve, Statistikave dhe Inovacionit në Agjencinë Kombëtare për Kontrollin e Cannabis-it, nën Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në prill të 2021 deri më 2024, ajo ka mbajtur rolin si Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve me Donatorë të Tjerë pranë Drejtorisë së Projekteve në Ministrinë e Brendshme.

Nga dhjetori 2020 deri në prillin 2021, ajo ka punuar si Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve pranë Agjencisë Kombëtare të Diasporës, ku ka kontribuar në forcimin e marrëdhënieve me diasporën shqiptare dhe në identifikimin e nevojave sektoriale për mbështetje nga instrumentet financiare të BE-së. Për më tepër, ajo ka punuar si Specialist i Programimit IPA të Bashkëpunimit Territorial nga tetori 2017 deri në dhjetorin 2020, duke koordinuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet IPA II të financuara nga BE.

E është angazhuar gjithashtu në zhvillimin profesional përmes trajnimeve të ndryshme, përfshirë çertifikata në Menaxhim dhe Politika Publike në Paris, si dhe trajnimet për Menaxhimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe Efikasitetin e trajtimit të borxhit në Shqipëri.

Ajo ka ndjekur me sukses trajnime në fushat e administratës publike, menaxhimit të projekteve dhe financave, duke dëshmuar kështu angazhimin e saj për t'u përmirësuar vazhdimisht dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë shqiptare.